LIGJ
Nr. 36/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT DHE PROJEKTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, "MARRËSI", TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM, "AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT", DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, "KFW", PËR MASAT SHOQËRUESE PËR FURNIZIMIN ME UJË TË ZONAVE RURALE III

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, "Marrësi", të përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar për Zhvillim, "Agjencia zbatuese e projektit", dhe KfW Frankfurt am Main, "KfW" për masat shoqëruese për furnizimin me ujë të zonave rurale III, me një grant në shumën 1 500 000 euro, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji dhe pjesëve përbërëse të tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.4.2015

Shpallur me dekretin nr. 9059, datë 27.4.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE FINANCIMI DHE PROJEKTI

Datë……

NDËRMJET KFW-SË, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH): (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR 1,500,000 EURO (MASA SHOQËRUESE), FURNIZIMI ME UJË NË ZONAT RURALE III
(NR. 2014 70 137)

Mbi bazën e një marrëveshjeje që do të lidhet ndërmjet qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (Marrëveshje Qeveritare), Marrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja (së bashku referohen si "Palët") lidhin Marrëveshjen e mëposhtme të Financimit dhe Projektit:

Neni 1
Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep Marrësit një kontribut financiar që nuk i kalon 1,500,00000 euro (Masa Shoqëruese).

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi e kanalizon kontributin financiar plotësisht në Agjencinë e Zbatimit të Programit në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Agjencia e Zbatimit të Projektit e përdor kontributin financiar ekskluzivisht për Masat Shoqëruese të projektit si fushatat e informimit dhe sensibilizimit dhe trajnimet e operatorëve (Projekti). Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcakton hollësitë e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar me marrëveshje të veçantë.

1.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi ose Agjencia e Zbatimit të Programit dhe detyrimet e importit nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2

Kanalizimi i kontributit financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit

2.1 Marrësi e kanalizon kontributin financiar tek Agjencia e Zbatimit të Projektit si një grant i pashlyeshëm sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2 Para disbursimit të parë nga kontributi financiar, Marrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në gjuhën angleze ose gjermane të marrëveshjes së specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i kontributit financiar nuk përbën ndonjë detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Livrimi

3.1 KfW-ja e livron kontributin financiar në pajtim me progresin e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Me marrëveshje të veçantë, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë për procedurën e disbursimit, veçanërisht për provat e vërtetimit që fondet e disbursuara janë përdorur për këtë qëllim të parashikuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të kryerjes së disbursimeve pas datës 30.6.2019.

Neni 4

Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Marrësi nuk përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, Marrëveshjes së Projektit dhe Huas së datës, Marrëveshjes së Financimit dhe Projektit ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj Marrëveshjeje, janë shkelur;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë që kontributi financiar është përdorur për qëllimin e parashikuar; ose

d) dalin rrethana të jashtëzakonshme që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

4.2 Nëse një nga situatat e përcaktuara në nenin 4.1/b ose "c" ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që është të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e specifikuar në nenin 4.1/b, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1/c, mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e parashikuar.

Neni 5
Kostoja dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që mblidhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transfertave dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6
Deklarimet kontraktuale dhe prokura

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona të caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me nënshkrime model të certifikuara prej tij ose saj përfaqësojnë Marrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori ekzekutiv i Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) dhe ata persona të tjerë të caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me nënshkrime model të certifikuara prej tij ose saj përfaqësojnë Agjencinë e Zbatimit të Programit në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Prokura nuk skadon derisa revokimi nga përfaqësuesi i autorizuar për atë kohë të merret shprehimisht nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklarim i dhënë nga palët kontraktuese sipas kësaj Marrëveshjeje janë me shkrim. Çdo njoftim ose deklarim i tillë quhet i marrë nëse mbërrin në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës përkatëse kontraktuese që i njoftohet palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main, Republika Federale Gjermane
Faks: +49 69 7431-2944
Për Marrësin: Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë
Shqipëri
Faks: 00355 42 228494
Për Agjencinë e Zbatimit të Projektit:
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga "Sami Frashëri", nr. 10
Tiranë
Shqipëri
Faks: 00355 42 2234885

6.3 Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë vetëm te marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së dhe Marrësit, nuk kërkojnë pëlqimin e Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

Neni 7
Projekti

7.1 Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) përgatit, zbaton, operon dhe e mban Projektin në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) u ngarkon përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit konsulentëve të pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) u jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga kontributi financiar me ofertë publike konkurruese ndërkombëtare paraprake;

d) mban ose merr masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe që identifikon qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky kontribut financiar;

e) u mundëson përfaqësuesve të KfW-së në çdo kohë inspektimin e këtyre librave dhe regjistrave dhe çdo dokumentacion tjetër të përshtatshëm për zbatimin e Projektit dhe të vizitojë Projektin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

f) i jep KfW-së çdo informacion dhe regjistra për Projektin dhe progresin e tij që mund të kërkojë KfW-ja.

7.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja mund të përcaktojnë hollësi në lidhje me nenin 7.1 me marrëveshje të veçantë.

7.3 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) siguron financim të plotë të Projektit dhe, me kërkesë, i jep prova KfW-së që provon se kostoja e cila nuk paguhet nga ky kontribut financiar, mbulohet; dhe

b) me iniciativë të tyre njoftojnë menjëherë KfW-në për të gjitha rrethanat që pengojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Projektit.

7.4 Marrësi asiston Agjencinë e Zbatimit të Programit në pajtim me praktikat e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Programit dhe në përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Programit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, veçanërisht, i japin Agjencisë së Zbatimit të Programit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

7.5 Për transportin e mallrave që duhet të financohen nga kontributi financiar, zbatohen dispozitat e Marrëveshjes Qeveritare, të cilat janë të njohura për Marrësin.

Neni 8

Dispozita të ndryshme

8.1 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit garantojnë që personat e ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e Projektit, dhënien e çdo kontrate për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen dhe kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar të mos kërkojnë, prezumojnë, japin, dhurojnë, premtojnë ose përftojnë një premtim për pagesa të paligjshme dhe avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Agjencia e Zbatimit të Projektit i ofron KfW-së menjëherë, me kërkesë, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit, e cila është e nevojshme për këtë qëllim.

Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emrin e saj dhe për llogari të vet. Në lidhje me ligjin gjerman dhe ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit:

a) burimet e veta të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose shumat e investuara në financimin e Projektit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

b) kapitali i aksionerëve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit nuk do të jetë me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk përfshihet në përftimin, zotërimin ose përdorimin e pasurisë që është me origjinë të paligjshme dhe, veçanërisht kjo listë nuk është shteruese, nuk lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionit, aktivitetin e organizuar kriminal ose terrorizmin; dhe

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të përfshihet në financimin e terrorizmit.

8.3 Nëse një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera

mbeten të pacenuara. Çdo boshllëk që rrjedh prej tij plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

8.4 Marrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të cedojnë, transferojnë, lënë peng ose rëndojnë me hipotekë asnjë pretendim të kësaj Marrëveshjeje.

8.5 Çdo ndryshim ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje është vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhet rregullisht nga të dyja palët. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të aprovohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin vetëm periudhën e disponibilitetit nuk kërkojnë aprovimin paraprak të Këshillit të Ministrave.

8.6 Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes është Frankfurt am Main.

8.7 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë së Zbatimit të Projektit mbarojnë në fund të jetës së dobishme të Programit, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

8.8 Kjo Marrëveshje Financimi dhe Projekti nuk hyn në fuqi nëse Marrëveshja Qeveritare në të cilën ajo bazohet nuk ka hyrë në fuqi.

Bërë në kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main
më _____
KfW

Tiranë
më _____

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë,
i përfaqësuar nga Ministria e Financave

Fondi Shqiptar i Zhvillimit